



# GRUPI SIGAL UNIQA RAPORTI VJETOR

# 2019



NËSE DËSHIRON TË SIGUROHENI  
ka vetëm **1** emër...

## NË NJË HAP ME SFIDAT!

# NE JEMI SIGAL UNIQA

NE jemi kompania lider në tregun e sigurimeve në Shqipëri, ku udhëheqim tregun vendas që prej vitit 2002, duke zotëruar mesatarisht 30% të tregut.

Grupi SIGAL UNIQA është një familje e madhe që numëron mbi 1500 punonjës dhe agjentë, të cilët u shërbejnë 1 milion klientëve në tre shtete: Shqipëri, Kosovë dhe Maqedonin e Veriut.

SIGAL UNIQA është ndër grupet më të mëdhenj finansiarë në rajon, i përbërë nga 7 kompani sigurimesh dhe 1 fond pensioni privat dhe zotëron 121.2 milionë Euro asete, numëron mbi 71.8 milionë Euro prime të shkruara për vitin 2019 dhe rreth 300 milionë Euro dëme të paguara ndër vite.

## Volumi i primeve (Euro)

Group	<b>71,848,000</b>
AL	42,909,000
KS	13,151,000
MK	15,789,000

## Nr. i zyrave

Group	<b>1137</b>
AL	505
KS	138
MK	327

## Nr. i kontratave

Group	<b>1,028,012</b>
AL	468,008
KS	96,153
MK	463,851

## Agjentë dhe punonjës

Group	<b>1558</b>
AL	796
KS	208
MK	554

## PËRMBAJTJA

### FJALA PËRSHËNDETËSE

Z. Andreas BRANDSTETTER  
CEO i UNIQA Insurance Group

Z. Avni PONARI,  
CEO i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA

### KUSH JEMI NE?

- Vlerat dhe parimet
- Kush jemi SIGAL
- Kush është UNIQA

### PERFORMANCA NË 2019

- Ngjarjet kryesore 2019
- Marketingu dhe Media
- Përgjegjësia sociale në sport, art, kulturë, edukim dhe punësim
- Produktet dhe shërbimet e një vlore të shtuar
- Dixhitalizimi dhe shërbimet e reja online
- Katastrofat natyrore: Shqipëria goditet nga dy tërmete shkatërruese

### Tregu rajonal i sigurimeve

### Raporti i audituesit të pavarur

### Raporti i Auditit të brendshëm

### Parimet e menaxhimit të riskut

### Objektivat

### Kontakte

6

10

14

30

32

39

46

52

53



Në një hap me Sfidat!

Të dashur lexues,  
Të dashur zonja dhe zotërinj,  
Të dashur aksionerë,

Në faqet në vijim, ne analizojmë vitin finansiar 2019 duke paraqitur Raportin Vjetor të Grupit SIGAL UNIQA për aksionerët dhe partnerët tanë strategjikë. Ndonëse bota rreth nesh mbetet e trazuar, viti 2019 ishte një vit shumë i kënaqshëm në shumë aspekte dhe ne kemi vazhduar që të rritemi më tej. Burimet e suksesit tonë janë të shumta: rritja e vazhdueshme e volumit të primeve dhe të fitimeve të sigurimeve të jetës dhe të jo jetës, përmirësimi i mëtejshëm i raportit të kombinuar dhe performanca e 'shëndetshme' e të ardhurave tona nga investimet e aseteve. Rrjedhimisht, performanca në këtë Raport është, në përgjithësi, shumë pozitive.

Këtë herë si asnje herë tjetër më parë në histori prospektet për të ardhmen janë shumë kontradiktore dhe të paparashikueshme. Kur filluan të punonim për përgatitjen e këtij Raporti, bota po përfjetonte ndryshime të thella, të vazhdueshme dhe të paprecedenta për shkak të shpërthimit dhe përhapjes së pandemisë së koronavirusit. Asnjë prej nesh nuk e di ende se çfarë do të sjellin javët, muajt dhe mundësish edhe vitet në vijim. Ndërsa vendi ynë, Shqipëria u godit në muajt shtator dhe nëntor nga dy tërmete të njëpasnjëshme shkatërruese me pasoja të jashtëzakonshme ekonomike dhe sociale në mbarëvendin.

Por një gjë është e sigurt: ne jemi të vendosur në përballimin e multisfidave aktuale, të së ardhmes, si edhe të zhvillimeve radikale në sektorin tonë. Për pasojë, ne mbetemi besimplotë se ne do të dalim nga kjo periudhë pasigurish me forca të ripërtëritura. Si të tillë, ne do të vazhdojmë të mbështesim klientët dhe aksionerët tanë që të jetojnë një jetë më të shëndetshme, më të sigurt dhe më të mirë në të ardhmen po ashtu. Punonjësit, agjentët dhe partnerët tanë ekskluzivë të shitjeve në çdo degë në të gjithë vendin, i kanë kthyer në veprat fjalët që frysëzojnë këdo në SIGAL UNIQA duke përkushtuar përpjekjet e tyre maksimale ndaj klientëve tanë ditë pas dite.

Ne sigurojmë të ardhmen tuaj!



# FJALA PËRSHËNDETËSE

*Të nderuar zonja dhe zotërinj,  
Të nderuar aksionerë;*

Viti finansiar 2019, i cili formoi gurin e themelit të programit strategjik UNIQA 2.0 të shpalosur në vitin 2011, ka qenë i kënaqshëm në çdo aspekt:

1. Fitimi nga aktivitetet e zakonshme në 296 milionë euro i tejkaloj pritshmëritë tona dhe përputhet me shifrat e një viti më parë edhe pse përfshinte diku tek 47 milionë euro në të ardhura të jashtëzakonshme nga shitja e aksioneve tona në Kazinonë Austria AG. Një zhvillim tjetër veçanërisht pozitiv këtu ishte fakti se tregjet e rritjes në rajonin e Evropës Qëndrore dhe Lindore janë duke kontribuar gjithnjë edhe më shumë në rritjen e fitimeve të Grupit – 71 milionë euro të rendësishëm në vitin 2019. Në të kundërt, mjedisi i vazhdueshëm me norma të ulta interesit ka patur një impakt negativ, më dukshëm në tregun e sigurimeve afatgjata të jetës dhe të shëndetit në Austri. Në vitin 2019, fitimet si rezultat i kontributit të tregut vendas të sigurimeve ishte 169 milionë euro.

2. Tendenca e biznesit operues u formësua deri diku nga rritja e primeve sipër pritshmërive tona me 1.2 përqind (+2.6 përqind në sigurimin e pasurisë dhe të aksidenteve, +4.1 përqind në sigurimin e shëndettit dhe -3.7 përqind në sigurimin e jetës), si edhe përmirësimet e mëtejshme të raportit të kombinuar neto në 96.4 përqind. Kjo na sjell një hap më afë objektivit tonë për të arritur nivelin 95 përqind në vitin 2020.

3. Aktivitetet tona investuese rezultuan gjithashtu në të ardhura të larta, duke gjeneruar të ardhura neto të investimeve prej 585 milionë euro, ose një kthim total prej 2.8 përqind. Ky është një rezultat shumë i kënaqshëm për vitin 2019 me normat e interesit ende tepër të ulta.

4. Pavarësisht impaktit të dukshëm të këtij mjedisi me norma të ulta interesit, niveli ynë i aftësisë paguese qëndroi në 216 përqind në fund të vitit 2019, p.sh., përparr faktorizimit të çdo efekti nga blerja e degëve të Grupit AXA në Poloni, në Republikën Çeke dhe në Sllovan.



**Andreas Brandstetter**  
CEO i UNIQA Insurance Group AG

“...ne do t'i trajtojmë me siguri ndryshimet e shumta dhe të shpejta me të cilat po përballet industria jonë në këtë aspekt. Për më tepër, ne jemi gjithashtu të vetëdijshëm për shumë mundësi të reja të tërheqëse...”

Zonja dhe zotërinj, viti finansiar 2019 jo vetëm që shënon gurin e themelit të programit tonë afatgjatë UNIQA 2.0 të prezantuar në vitin 2011. Ky vit shtron gjithashtu themellet përfshinë e re të strategjisë sonë – UNIQA 3.0 – nga viti 2020 deri në vitin 2024. Përse do të jenë veçanërisht kaq të rendësishëm për UNIQA-n pesë vitet në vijim?

Në nëntë vitet e kaluara, biznesi i sigurimeve globale ka parë një revolucion të një shkalle të paprecedentë: “Aftësia Paguese II” e vitit 2016 ka rishkuar plotësisht regullat e industrisë sonë. Gjendja e normave të interesit i ka shkaktuar një numri të madh kompanish evropiane probleme prej disa vitesh tashmë, duke i detyruar disa prej tyre që të ndërmarrin veprime drastike. Zhvillimet teknologjike në fusha të tillë si dixhitalizimi dhe inteligjenca artificiale kanë gjetur rrugën e tyre për tek sektori ynë me shpejtësi frymëmarrëse. Kompanitë e sigurimit teknologjik dhe të teknologjisë financiare ultra të shpejta kanë rritur sulmin e tyre të përditshëm ndaj siguruesve tradicional. Kufijtë që ndajnë sigurimin nga industritë e tjera të tillë si industria automotive, shkenca

e të dhënavë dhe të shëndetit janë duke u zgjeruar. Individë të rinj, të talentuar, të sapodalë nga shkolla apo universiteti kanë një pasuri punësh tërheqëse ku mund të zgjedhin nga e gjithë bota, dhe ata me të vërtetë të mirë midis tyre rrallë u jasin siguruesve një shans të dytë. Në krye të këtyre, pritshmëritë e klientëve tanë janë duke evoluar me shpejtësi – standardi për shërbime të cilësisë më të lartë të përshtatshme për epokën moderne është në ngjitje për ditë nga përvojat e individuve në jetët e tyre personale.

Ne gjithashtu kemi ndryshuar në këto nëntë vite. Ne jemi bërë një UNIQA e ndryshme. Dëshirojmë të mëndojmë një UNIQA edhe më e mirë. Ne jemi rritur, sepse ne e kemi mbajtur premtimin e brand-it tonë dhe sepse ne e kemi dyfishuar numrat e klientëve tanë me 7.5 milionë deri diku në 15 milionë – pavëresisht tërheqjes nga tregjet gjermane dhe italiane, dhe duke marrë në konsideratë transaksionet tona të planifikuara me Grupin francez AXA. Ne kemi ndryshuar shumë procese, duke marrë edhe disa kthesa të gabuara gjatë rrugës. Ne kemi filluar disa projekte kryesore, duke përfshirë një transformim kompleks dhe me kosto të biznesit tonë dëshirojmë të teknologjisë së informacionit për të cilat do të duhen disa vite. Dhe ne kemi përmirësuar në mënyrë të konsiderueshme bazën e kapitait tonë dhe, kështu kapacitetin e fitimeve tona, kryesisht nëpërmjet ofertave fillestare publike në tetor 2013.

Megjithatë, kjo nuk do të mbetet e shkëlqyer në një periudhë më afatgjatë – madje edhe më shumë me shpërthimin e krizës së koronavirusit, e cila aktualisht ka vendosur në pikëpyetje çdo përpjekje për të parashikuar të ardhmen. Për më tepër, ne do ta bëjmë modelin ekzistues të biznesit tonë shumë më të mirë dhe efektiv sërisht, ndërkokë që gjithashtu do të na duhet të bëjmë inovacionet më të fundit të disponueshme ndaj klientëve tanë shumë më shpejtë. Me fjalë të tjera, ne do të pësojmë një transformim tjetër, ashtu siç kemi bërë që nga viti 2011 si pjesë e UNIQA 2.0. Programi ynë strategjik për pesë vitet e ardhshme, UNIQA 3.0, është hartuar për të na dhënë shyllat drejtuese dhe gurin tonë kilometrik për këtë udhëtim.

Ne do të krijojmë kuadrin strukturor të nevojshëm në shtator 2020, e cila do të marrë efekt retroaktiv që nga data 1 janar 2020 me termat e bilancit: ne jemi duke shqyrtau strukturën e Grupit tonë duke shkrirë ‘UNIQA Österreich Versicherungen AG’ me ‘UNIQA International AG’. Kjo “UNIQA e Re Österreich Versicherungen AG”,

e cila do të jetë përgjegjëse për të gjithë biznesin e sigurimeve parësore të Grupit, do të mbetet një degë në pronësi të plotë të kompanisë ‘UNIQA Insurance Group AG’. Megjithatë, ndryshtë nga tani, ‘UNIQA Insurance Group AG’ do të jetë një kompani tërësisht aksionere dhe do të pushojë të gjitha operacionet e saj. UNIQA Insurance Group AG dhe “UNIQA e Re Österreich Versicherungen AG” do të ndajnë të njëjtin Bord Mbikëqyrës dhe Bord Menaxhimi. Ne synojmë prezantimin e detajeve të UNIQA 3.0 për ju, drejt fundit të vitit 2020. Megjithatë, në javët dhe muajt e tjerë në vijim, sigurisht që ne do t'i trajtojmë ndryshimet e shumta të shpejta me të cilat po përballet industria në këtë aspekt. Për më tepër, ne jemi gjithashtu të vetëdijshëm për mundësitë e shumta tërheqëse që po i prezantohen ofruesve të shërbimeve financiare – duke i aftësuar ata që t'i ofrojnë klientëve të tyre vlerë të shtuar duke i ndarë ata qartësisht nga konkurrentët e tyre dhe premtimi i një brand-i së cilës ata i besojnë.

“Ne do të mbetemi besimplotë, sërisht, se ne do të dalim nga kjo periudhë pasigurish me forca të ripërtëritura”.

Zonja dhe zotërinj, impakti i krizës së koronavirusit ka bërë që forca e plotë e pranisë së virusit të ndihej nga secili prej nesh gjatë pak javëve të fundit. Çdo ditë sjell informacion, gjetje dhe ndryshime të reja. Dëshirojmë të kërkojmë mirëkuptimin tuaj nëse disa pasazhe në këtë fjalë përshëndetëse, e cila është rishikuar disa herë, ju jep përshtypjen, teksa i lexoni ato, se zhvillimet që rrethojnë COVID-19 na kanë rrëmbyer sërisht nga afati ynë editorial, që në fakt mund të ketë qenë rasti. Është e vështirë që të bëjmë parashikime, veçanërisht rrëth së ardhmes. Kjo deklaratë, me kuptim ironik, i përshtatet shumë mirë situatës aktuale. Për ne gjithashtu, rrethanat ku gjendemi po sjellin një nivel të panjohur mjetullish për parashikimet tona. Megjithatë, ne mabetemi besimplotë se, sërisht, ne do të dalim nga kjo periudhë pasigurish me forca të ripërtëritura.

Dëshiroj ta përmbyll duke ju ofruar falënderimet e mia të përzemërtë, në emër të kujtdo që punon në UNIQA, për interesin dhe besimin tuaj tek Grupi ynë. Shpresoj të vazhdoj të luajë një rol të vogël për t'u siguaruar se jo vetëm klientët tanë por gjithashtu, dhe në veçanti, ju, aksionerët tanë të jetonit një jetë më të sigurt, më të mirë dhe më të gjatë.

**Andreas Brandstetter**  
Në emër të Bordit Ekzekutiv të Grupit

# FJALA PËRSHËNDETËSE

## Të nderuar partnerë dhe klientë,

Me përmbylljen e ciklit të parë 20-vjeçar dhe çeljen e dekadës së tretë të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA, viti 2019 ishte një vit arritjesh pozitive të suksesshme dhe të qëndrueshme. Megjithëse, nuk ishte gjithmonë e lehtë, ky vit ishte gjithashtu i pasur në sfida – dy tërmete shkatërruese dhe pagesa e dëmeve - dhe i karakterizuar nga një mjesid edhe më dinamik zhvillimesh të ndryshueshme, por objektivat tonë financiar ambicioz përgjatë vitit, u tejkalan dhe mirëbesimi dhe besimi tek biznesi ynë mbetet solid dhe vazhdon të rritet çdo ditë. Më shumë sesa kaq, unë jam shumë i kënaqur me energjinë që i është përkushtuar suksesit afatgjatë të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA. Ne jemi të fokusuar tek klientët tanë dhe thjeshtësimi i biznesit. Nëpërmjet inovacionit me ju në mendje, ne kemi korru progres të madh lidhur me vet strategjinë tonë. Ne kemi vijuar me kërkimin, gjetjen dhe prodhimin e ideve dhe të këndvështrimeve novatore që ofrojnë përfitime maksimale për të gjithë klientët, partnerët e biznesit, punonjësit dhe aksionerët tanë - tani dhe në të ardhmen.

Tashmë prej më shumë sesa 2 dekada, ne kemi qenë gjithmonë përvrara kohës sonë, duke përqafuar mënyrat më të fundit dhe më të reja të të bërit biznes, fjalën e fundit të teknologjisë dhe inovacioneve, teksa përpinqeshim, në të njëjtën kohë, për të gjetur mënyra të reja për t'i shërbyer "par excellence" të gjithë klientëve dhe partnerëve tanë, si edhe për të mbrojtur ata që varen nga ne. Qëllimi ynë si sigurues është mbrojtja e njerëzve. Tradicionlisht, kjo ka nënkoputar përpunimin dhe pagesën e dëmeve menjëherë. Tani, taknologjia po krijon mundësinë për t'ju mbrojtur juve madje edhe përpara se një aksident të ndodhë: duke ju paralajmëruar. Ne jemi krenarë që e kemi arritur këtë. Përvaja dhe aftësia jonë për t'u përshtatur ndaj një mjesid biznesi gjithnjë në ndryshim, na lejon që ta shikojmë të ardhmen me besim dhe shpresë.

Përgjatë vitit 2019, - pavarësisht dy tërmeteve me përmasa shkatërruese që goditën vendin tonë me dëme totale mbi 1 miliard euro dhe vështirësive e presionit për dëmshpërbirim të menjëhershëm, ku SIGAL UNIQA kishte portofolin më të madh të sigurimeve të pasurisë (individë dhe biznese) me një vlerë dëmi prej mbi 12 milionë euro - performanca jonë financiare ishte e fortë dhe e qëndrueshme, dhe po këshfu është edhe shëndeti ynë organizativ: Menaxherët dhe stafi ynë kanë jetësuar plotësisht strategjinë tonë – gurin



**Avni Ponari**  
CEO i SIGAL UNIQA Group Austria

tonë të themelit – që është fari ynë vizionar, strategjik dhe financiar i së ardhmes sonë të përbashkët, për të garantuar një jetë më të shëndetshme, më të sigurt dhe më të mirë. Këtu, në SIGAL UNIQA, ne kemi krijuar një mjesid që është i hapur dhe promovues i pandëprerë i ndryshimit – një faktor thelbësor në kohë jashtëzakonisht të trazuara dhe të paqëndrueshme si këto që po kalojmë. Kjo frymë e re ndjehet në të gjithë organizatën dhe instrumentet tona të brendshme për të matur performancën e liderisës dhe kulturën e performancës. Talenti, mprehtësia dhe pasioni i mbi 1,500 punonjësve tanë kanë bërë që ne t'i tejkalojmë të gjitha sfidat dhe targetet tona dhe niveli i kënaqësisë së klientëve tanë është rritur në mënyrë të qëndrueshme. Tek ne ata shikojnë një partner të besueshmë se ku mund të mbështeten për mbrojtjen e tyre dhe të aseteve të tyre më të çmuara.

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ka një histori të gjatë të shkuari PËRMBI dhe PËRTEJ për njerëzit që na kanë besuar. Ata kanë qenë themelet e suksesit tonë përmbi 2 dekada. Shume njerëz, veçanërisht gjeneratat e reja, po përballen me një të ardhme të pasigurt. Si një kompani sigurimi biznesi thelbësor i së cilët është mbrojtja, ne kemi një përgjegjësi të veçantë në krijimin e një mjesidi kur të gjithë të mund të lulëzojnë. Ne e marrim këtë përgjegjësi me shumë seriozitet dhe ne jemi në lartësinë e duhur, sepse falë bazës sonë të gjerë ne jemi në kontakt thuajse me çdo njeri nga

ndryshimet dramatike që ndodhin në shoqëri. Në vitin 2019, ne treguan angazhimin tonë të plotë dhe të qartë për të ndihmuar individët dhe bizneset duke iu gjendur atyre pranë 24/7 dhe në përbushje kapilare të të gjitha përgjegjësive dhe detyrimeve tona kontraktuale. Me SIGAL UNIQA askush nuk mbetet vetëm dhe prapa. Ka qenë detyra jonë që t'ju ndihmonim të përshtateshit me ndryshimet e ndodhura dhe për të ndërtuar së bashku besimin tek e ardhmja. Në vitin 2020, këto angazhime do të ndiqen me veprime konkrete.

Edhe këtë vit, në 2019, të gjitha përpjekjet tona u investuan për t'u bërë edhe më të thjeshtë dhe më novatorë në punën tonë, duke ju sjellë çdo produkt dhe shërbim online, mdaje deri tek raportimi i dëmit online. Udhëtimi transformues që po ndjekim dhe zbatojmë ka të bëjë me vendosjen e klientëve në zemrën e çdo gjëje që ne bëjmë dhe duke dëgjuar nevojat tuaja. Ne kryejmë sondazhe të vazhdueshme lidhur me nivelin e kënaqësisë së klientëve tanë, duke marrë me qindra mijëra përgjigje prej tyre, si edhe mënyra alternative për përmirësimin tonë të mëtejshëm. Në vitet që do të vijnë, ne planifikojmë përspejtimin e këtyre përpjekjeve dhe tejkalinim e pritshmërise tuaja mbi se çfarë mund të bëjnë sigurimet. Klientët po jetojnë gjithnjë edhe më shumë brenda ekosistemeve të ndërlidhura, dhe ne synojmë që të rrisim praninë tonë në këto mjesid të dixhitalizuara online, duke ofruar shërbime më të zgjuardhur për udhëtarët, bizneset, mbrojtjen e shtëpisë, në përgjithësi, si edhe të jetës, shëndetit dhe mirëqenies, në veçanti.

NE po i përgjigjemi dita ditës mjesidit në ndryshim të biznesit, duke adresuar ndërrimin e gjeneratën e mijëvjeçarit dhe për të tjerë që kërkojnë mbulim individual dhe më fleksibël; NE po rekrutojmë dhe mbajmë njerëzit më të mirë, sepse për të ofruar shërbimet më të mira për klientët tanë, ne kemi nevojë për talentet më të mira; NE po gjurmojmë risqet në një botë të ndërlidhur, duke punuar ngushtësisht me klientët tanë për identifikimin e risqeve deri tek ndërlidhshmëria dhe bota e re kibernetike dhe mundësitet e sfidat që ajo ka hapur; NE po kthehem i një biznes edhe më të qëndrueshëm, duke zbatuar masa për një biznes më të qëndrueshëm dhe fokusin e veçantë ndaj ndryshimeve klimaterike që po na prekin të gjithëve; NE po ecim krahë për krahë me zhvillimet më të fundit të tregjeve financiare në përputhje me profilin tonë si investitor afatgjatë dhe misionin tonë për të arritur fitime superiore të mirëpërshtatura; NE po forcojmë liderisësin tonë në tregt, duke vijuar me ndërtimin, rruajtjen dhe rritjen e pozicionit

numër një si sigurues ndaj klientëve të kompanisë sonë; NE po bëhem i më të sofistikuar paralelisht me sofistikimin e pandëprerë të klientëve tanë, duke kërkuar për zgjidhje në menaxhimin dhe parandalimin e risqeve; dhe së fundmi, NE po tërheqim talentet më të spikatura dhe të shumëlojshme, me besimin se e ardhmja jonë varet prej tyre.

Me përspejtimin e shpejtësisë së ndryshimeve në industrinë tonë, suksesi ynë i deritanishëm, përbushja e gamës së gjerë të sfidave me të cilat jemi përballur dhe mënyrave se si i jemi gjendur pranë kleintëve tanë, na jepim besimin e prosperitetit dhe lulëzimit tonë të mëtejshëm në këtë mjesid dinamik ndryshimesh. Rrjedhimisht, ne kemi vendosur targete të reja financiare ambicioze për vitin 2020, dhe Bordi ynë po punon ngushtësisht me menaxhimin për t'i kthyer këto angazhime në impakte të prekshme.


Së bashku, me njerëzit tanë, ne do ta kthejmë vitin 2020 në një kapitull krenar të historisë sonë. Pasi kemi arritur kaq shumë, udhëtimi ynë vazhdon. Performanca jonë prej mbi 2 dekada na ka vendosur në një pozicion të shkëlqyer, të kategorisë së parë për përbushjen e objektivave të strategjisë me klientët në qendër për të punuar me energji dhe me ambicie për çka na pret.

Duke ju falënderuar përzemërsisht të gjithëve për besimin që keni tek ne dhe për mbështetjen tuaj në këtë udhëtim, jam besimplotë në kapacitet, potencialin dhe energjitet tona të paepura për të rrugëtar së bashku nën frymën e progresit dhe të pasionit të ekipit që unë drejtoj me krenari.

Miqësish,

**Avni PONARI**  
Drejtë i Përgjithshëm  
SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Sh.a  
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës të SIGAL UNIQA

# Bordi Mbikëqyrës SIGAL UNIQA Group Austria



## Aksionerët tanë



Andreas Brandstetter  
Kryetar i Bordit Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA  
CEO i UNIQA Insurance Group



Erhard Busek  
Zv. Kryetar i Bordit  
Mbikëqyrës, SIGAL UNIQA



Wolfgang Kindl  
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,  
SIGAL UNIQA  
CEO i UNIQA International



Alexander Breit  
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,  
SIGAL UNIQA



Gerald Mueller  
Anëtar i Bordit Mbikëqyrës,  
SIGAL UNIQA

## PARIMET DHE VLERAT

Katër janë fjalët që pëershkruanjë më mirë misionin e SIGAL UNIQA Group AUSTRIA:

Klientët tanë duhet të gjeljnë një jetë më të shëndetshme, më të sigurt dhe më të mirë. Sot ne jemi dëshmitarë të gjallë të evolucionit të inovacioneve në industrinë e sigurimeve të shekullit të XXI-të. Ndryshimet marramendëse kapilare të sjella nga shpejtësia e Revolucionit të 4-ërt Industrial në Teknologji dhe Dixhitalizim kanë shkaktuar ndryshimin e sjelljes dhe të prishmërive të konsumatorëve dhe të tregjeve financiare po ashtu. Dhe rreziqet e reja të sjella nga këto teknologji të reja krijojnë kërkesa të reja për mbrojtje.

Si ofrues shërbimesh, ne kërkojmë të përdorim produktet dhe shërbimet tona direkte dhe të cilësisë më të lartë sa më mirë që të jetë e mundur për të ndihmuar klientët tanë që të gjeljnë një siguri dhe liri më të madhe në jetët e tyre. Ne punojmë, luftojmë dhe investohemi që të përmirësohem çdo ditë, sepse ne jemi shumë serioz në punën dhe misionin tonë. Ne i përbushim premtimet dhe angazhimet tona maksimalisht çdo ditë dhe në çdo aspekt me gëzim dhe angazhim absolut.

### Frymëzojmë

Ne i mundësojmë dhe ndihmojmë klientët tanë që të jetojnë një jetë më të shëndetshme, më të sigurt dhe më të mirë sepse ne jemi të interesuar tek njerëzit dhe sepse njerëzit janë aseti ynë më i çmuar.

### Formësojmë të ardhmen

Ne jemi novatorë pararojë në industrinë e sigurimeve dhe vazhdojmë të zhvillohemi duke adresuar në kohë rekord të gjitha ndryshimet e shpejta teknologjike, dixhitale, qytetare, demografike dhe ato sociale, paralelisht me çdo ndryshim të kërkuar të vet produkteve dhe shërbimeve tona.

### Jemi të drejtpërdrejtë

Ne jemi të saktë, të shpejtë, të ndershëm dhe të drejtpërdrejtë.

### Investojmë

Ne vazhdojmë të përmirësojmë strategjinë tonë të investimeve veçanërisht investimet e qëndrueshme që marrin në konsideratë objektivat e modelit "Njerëzit, Planeti dhe Përfitimi".

## FRYMËZOJMË

Ne i mundësojmë dhe ndihmojmë klientët tanë që të jetojnë një jetë më të sigurt, më të mirë dhe më të gjatë sepse ne jemi të interesuar tek njerëzit.

## FORMËSOJMË TË ARDHMEN

Ne jemi novatorë pararojë në industrinë e sigurimeve dhe vazhdojmë të zhvillohemi duke adresuar në kohë rekord të gjitha ndryshimet e shpejta teknologjike, qytetare, demografike dhe ato sociale.

## JEMI TË DREJTPËRDREJTË

Ne jemi të saktë, të shpejtë, të ndershëm dhe të drejtpërdrejtë.

## INVESTOJMË

Ne vazhdojmë të përmirësojmë strategjinë tonë të investimeve veçanërisht investimet e qëndrueshme që marrin në konsideratë objektivat e modelit "Njerëzit, Planeti dhe Përfitimi".



## FORMËSOJMË TË ARDHMEN SË BASHKU

Njerëzit që punojnë me Grupin SIGAL UNIQA në rajon, në 3 vende – Shqipëri, Kosovë, Maqedoninë e Veriut – vijnë nga një grup profesionesh të larmishme - nga praktikantët e shitjeve deri tek matematicienët, inxhinierët dhe mjekët. Pavarësisht përvojave dhe background-it të ndryshëm arsimor, ata që të gjithë ndajnë diçka thelbësore: një pasion të përbashkët për SIGAL UNIQA dhe një dëshirë e përkushtim për të luajtur një rol aktiv në formësimin e së ardhmes. Parimi qëndror është angazhimi ynë për të mbështetur klientët tanë të jetojnë një jetë më të shëndetshme, më të sigurt dhe më të mirë. Gjithçka duam është krijimi i së njëjtës kulturë brenda kompanisë që ne po punojmë për ta projektuar edhe në botën e Jashtme.

### Mirëseerdhët

Kur punonjësit e rinj fillojnë punën në SIGAL UNIQA, ne i prezantojmë ata me kompaninë duke u fokusuar në tre fusha: njohjen e bashkëpunimin me punonjësit e tjerë, të mësuarit rreth "universit SIGAL UNIQA", dhe njohja me anëtarë të ndryshëm me profil të lartë të komunitetit të profesionistëve të SIGAL UNIQA. Për të tjerë, vëmendjen e njerëzve më të talentuar në SIGAL UNIQA si punonjës potencial në një fazë të hershme, ne fokusohemi veçanërisht në kontaktin me potenciale të larta nëpërmjet programit tona disa vjeçar të praktikës në SIGAL UNIQA.

### Trajnimi dhe edukimi i vazhdueshëm

Edukimi i vazhdueshëm është pjesë e jetës së përditshme të punës në SIGAL UNIQA – në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut. Ne punojmë vazhdimisht për adoptimin dhe përmirësimin e moduleve tona të trajnimit të brendshëm dhe vazhdimin e pandërprerë të programeve edukuese dhe të mësuarit elektronik. Modulet e trajnimit janë një ndërthurje e librarisë dhe me video në rajon dhe nga përvoja 200 vjeçare e gjigandit të sigurimeve në Austri dhe në Evropën Qëndrore dhe Lindore – UNIQA Insurance Group. Temat variojnë nga të punuarit në mënyrë të vetëdijshme deri tek puna e orientuar tek objektivat.

### Zhvillimi dhe përparimi

Si pjesë e politikës strategjike të Burimeve Njerëzore të SIGAL UNIQA, ne identifikojmë punonjësit me potencial të lartë, duke treguar se si i vlerësojmë ne ata duke promovuar dhe investuar në zhvillimin e tyre.

### Të motivuar dhe të angazhuar

Në vitin 2019 ne kryem sërisht një sondazh gjithëpërfshirës të punonjësve të Grupit SIGAL UNIQA – në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut me fokusi të veçantë mbi situatën e punës e proceset e punës, kulturën e menaxhimit, orientimin e objektivave, zhvillimin profesional dhe imazhin e korporatës.

# NGJARJET KRYESORE 2019

## 20 VJET SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA

Viti 2019 ishte 20 vjetori i themelimit të SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dhe rruga e suksesshme dhe solide drejt çeljes së dekadës sonë të 3-të. Inaguruam skulpturën "Mirënjoye dhe falënderim për të gjithë"; festuam 20 vjetorin; Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA u dekorua "GRAND DECORATION OF HONOUR" nga Presidenti i Austrisë dhe "THE ORDER OF THE RISING SUN, GOLD RAYS WITH NECK RIBBON" nga Perandori Japonez, si edhe u shpall BIZNESMENI I VITIT 2019 nga GAZETA KOHA JONË; u vlerësuam si Superbrand Albania 2019; morëm pjesë me sukses në panaire kombëtare dhe ndërkombëtare; zhvilluam Analizën Vjetore të

Kompanive të Grupit SIGAL UNIQA për vitin 2019; hapëm Zyrën e Re të pritjes së klientëve për dëmet motorrike; ishim të pranishëm me aktivitetet tona në të gjithë median audio-vizive me video/reklama të produkteve/shërbimeve, si edhe me artikuj, shkrime, intervista dhe çmime; në përmbrushje të përgjegjësive sociale të Kompanisë vazhduam të ndërtotonim më tej me të gjitha angazhimet tona në sport, trashëgimi kulturore, art, kulturë, shëndet, edukim dhe punësim; vijuam me transformimin tonë të pandërprerë dixhital dhe teknologji nën moton "E ardhma është online" me Botën Dixhitale SIGAL UNIQA dhe sjelljen e produkteve të reja online.



Me rastin e 20 vjetorit të themelimit SIGAL UNIQA inauguroi skulpturën: "Mirënjoye - Falenderim për të gjithë", e vendosur pranë Drejtorisë së Përgjithshme të SIGAL UNIQA, në shenjë mirënjoye dhe falenderimi për klientët, bashkëpunëtorët dhe stafin për besimin dhe përkushtimin ndaj kompanisë për 20 vite. Në ceremoninë e inaugurimit morën pjesë, Bordi Drejtues i SIGAL UNIQA, Kryetari i Këshillit Bashkiak të Tiranës, përfaqësues të institucioneve më të larta publike, trupit diplomatik, biznesit dhe institucioneve financiare, si edhe nga stafi dhe partnerët e kompanisë.



### Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari nderohet më 20 qershor 2019 me dekoratën: "GRAND DECORATION OF HONOUR" nga Presidenti i Austrisë

Mbrëmja e 20-vjetorit të SIGAL UNIQA shënoi edhe një ngjarje tjetër të rëndësishme për themeluesin dhe drejtuesin e kompanisë më të madhe të sigurimeve në vend, Z. Avni Ponarin, i cili u nderua nga Presidenti i Austrisë me dekoratën "GRAND DECORATION OF HONOUR", të dorëzuar në emër të Presidentit të Austrisë nga Ambasadori i Austrisë në Shqipëri, Sh.T.Z Ambasadori Johann Sattler.

Ky është vlerësimi i parë që i bëhet një biznesmeni në Shqipëri nga shteti i Austrisë. "SIGAL UNIQA është një kampion i vërtetë ekonomie në vend", tha Sh.T.Z Ambasadori Satler gjatë dorëzimit të Dekoratës Z. Ponari. "Shpreh mirënjoyjen time dhe jam i nderuar nga vlerësimi përmes kësaj dekorate. Unë jam krenar që përmes SIGAL UNIQA solla në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut investitorin e parë strategjik në industrinë e sigurimeve UNIQA Insurance Group. Biznesi shqiptar dhe Shqipëria aspirojnë për t'u bërë pjesë e Evropës dhe se me standartet dhe garancitë ndërkombëtare, me produktet, shërbimet dhe stafin e tij tashmë janë pjesë e Evropës prej 20 vitesh", u shpreh Z. Ponari gjatë fjalës së tij.



## Kardinal Ernest Simoni Troshani vizitoi zyrat e SIGAL UNIQA

Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari u nnderua me vizitën dhe praninë e Eminencës së Tij, Kardinal Ernest Simoni Troshani pranë zyrave të SIGAL UNIQA Group Austria. Eminenca e Tij, Kardinal Troshani u prit nga Z. Ponari, me të cilin bashkëbiseduan për disa minuta dhe më pas u përhëndet me stafin dhe drejtues të tjerë të kompanisë.



## Analiza Vjetore Financiare 2019

Përmbylltet me sukses Takimi Vjetor 2019 i kompanive te Grupit SIGAL UNIQA Shqiperi, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut.

**Hapet zyra e re e pritjes së klientëve për dëmet motorike**  
 SIGAL UNIQA hap një ambjet të ri pritjeje për klientët që kanë patur një aksident automobilistik dhe duhet të plotësojnë dokumentat e nevojshëm për të marrë dëmshpërbllim. Kjo zyrë shërben gjithashtu për të marrë informacion të plotë mbi të gjithë dokumentacionin e nevojitur në rast dëmi. SIGAL UNIQA synon përmirësimin e shërbimit ndaj klientëve dhe kjo është arsyja përse ne investojmë vazhdimesh në përmirësimin e mqediseve të punës. Në këtë linjë SIGAL UNIQA ka krijuar dhe hapur gjithashtu një qendër të posaçme për t'i ardhur në ndihmë klientëve - Qendra e Asistencës për të Dëmtuarit nga Aksidentet Automobilistike.

## SIGAL UNIQA merr pjesë me sukses në Panairin e Agrobiznesit

SIGAL UNIQA ishte pjesëmarrëse në edicionin e 2-të të "Panairit Ndërkombëtar të Agrobiznesit dhe Agroteknikës", i zhvilluar në EXPO CITY. Stenda e SIGAL UNIQA në panair u vizitua edhe nga Kryetari i Bashkisë, Z. Erion Veliaj, i cili përgëzoi stafin dhe kompaninë SIGAL UNIQA për punën e kryer jo vetëm për sigurimet në fushën e bujqësisë dhe blektorisë, por për të gjitha shërbimet që i ofrohen qytetarëve dhe, në veçanti, për kontributin e vazhdueshëm të dhënë për zhvillimin social dhe ekonomik të qytetit të Tiranës.



## SIGAL UNIQA merr pjesë me sukses në Panairin e Turizmit Ndërkombëtar

SIGAL UNIQA ishte pjesëmarrëse në edicionin 3-të të panairit "Panairi i Turizmit Ndërkombëtar Tiranë 2019", i organizuar në mjetin e Decembrit. Kryefala e SIGAL UNIQA në këtë panair ishin sigurimet e pasurisë dhe të përgjegjësive që kanë hotelet dhe restorantet ndaj palëve të treta.



## Vlerësimet kombëtare dhe ndërkombëtare

Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari nderohet më 3 nëntor 2019 me dekoratën: "THE ORDER OF THE RISING SUN, GOLD RAYS WITH NECK RIBBON" nga Perandori Japonëz.

Z. Avni Ponari u dekorua për kontributet e tij të jashtëzakonshme dhe punën e kryer për promovimin e shkëmbimeve dhe forcimin e mëtejshëm të marrëdhënieve miqësore mes Shqipërisë dhe Japonisë, si Konsull i Përgjithshëm Nderi i Japonisë në Tiranë gjatë dhjetë viteve të fundit. Ambasada e Japonisë në Shqipëri shprehu admirimin dhe vlerësimin e saj të sinqertë ndaj Z. Ponari për kontributin e tij dhe përpjekjet e tij të vazhdueshme.

Drejtori i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA, Z. Avni Ponari shpallet: BIZNESMENI I VITIT 2019 nga GAZETA KOHA JONË.

SIGAL UNIQA vlerësohet si Superbrand Albania 2019  
 SIGAL UNIQA Group AUSTRIA u vlerësua për herë të dytë rradhazi me çmimin "Superbrand Albania" nga SUPERBRAND INTERNATIONAL, në Londër. Superbrand International është i pranishem në 90 vende të botës, duke përfshirë edhe Shqipërinë, i përbërë nga përfaqësues nga akademia, biznesi dhe media. Këshilli i SUPERBRAND vlerëson kompanitë në bazë të besueshmërisë, korrekësise dhe shërbimit ndaj klientëve.

SIGAL UNIQA shpallet fituese e Çmimit të Filantropisë 2019 në Nivel Kombëtar

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA shpallet fituese e: ÇMIMIT TË FILANTROPISË 2019 NË NIVEL KOMBËTAR Më 7 shkurt 2020, Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim kanë vlerësuar filantropinë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA duke i akorduar Çmimin e Filantropisë 2019 në Nivel Kombëtar me motivacionin: "Për angazhim dhe kontribut të gjerë në shëndetësi, arsim, mjesis, art, sport dhe edukim financiar në fushën e sigurimeve, ku veçohen: Klinika Lëvizëse Mjekësore në shkallë vendi, rikonstruksioni i Shkollës së Mesme të Bashkuar "Matosh UKA" në Fierzë, Tropojë dhe Pallatit të Sportit në Përmet, si dhe krijimi i Klubit "Art dhe Kulturë" në dispozicion për të gjithë qytetarët e Durrësit".

SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA Kosovë shpërblehet me "Çmimin Tatimpagusi i Vitis 2019", në përgjëzim të suksesit dhe arritjeve përgjatë vitit 2019.



# UNIQA - NJË PREJ KOMPANIVE MË TË MËDHA TË SIGURIMEVE NË EUROPE

UNIQA Insurane Group është prezente në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoni që prej vitit 2007, si aksioneri kryesor i SIGAL UNIQA.

UNIQA është një prej grupeve më të fuqishëm financiarë në Austri dhe në Europën Qendrore dhe Lindore.

Gjigandi i sigurimeve ka një histori mbi 200-vjeçare në tregun e sigurimeve dhe përbëhet nga rreth 19,200 punonjës që iu shërbejnë mbi 10.5 milionë klientëve në 16 shtete.

Me 21% të tregut, UNIQA është kompania e dytë më e madhe në Austri. Aktiviteti i grupit UNIQA është i shtrirë në 16 shtete të Europës Qendrore-Lindore, ku operon përmes 40 kompanive sigurimi.



UNIQA Insurance Group  
Vjenë, Austri

## MEDIA DHE MARKETINGU

### 20-Vjetori i SIGAL UNIQA në media

Thuajse të gjitha mediat audio-vizive dhe ato online pasqyruan 20-Vjetorin e SIGAL UNIQA, duke u fokusuar kryesisht në veprën e veçantë dhe kuptimplotë që SIGAL UNIQA realizoi dhe vendosi në qendër të Tiranës, në shenjë falëndërimi për klientët, bashkëpunëtrët dhe stafin.

#### Spoti i ri "20 Vjet SIGAL"

Përveç aktiviteteve të ndryshme për të festuar 20-Vjetorin e themelimit të kompanisë, SIGAL UNIQA solli një reklamë televizive motivuese dhe falënderuese për të gjithë klientët, bashkëpunëtorët dhe stafin që kanë qenë pranë SIGAL UNIQA përgjatë këtyre 20 viteve.

Marketimi në fokus i produktit të Pensionit Privat Prej muajit janar një fokus i veçantë i marketimit ka qenë produkti i Pensionit Privat i shpjeguar në forma të ndryshme, me tabela, video përshkruese dhe informuese, të dhëna dhe informacione për qytetarët që të kuptojnë përfitimet reale nga ky produkt, i cili është me të vërtetë një domosdoshmëri fitimprurëse për këdo. Kanalet tona të komunikimit me publikun e gjerë kanë qenë mediat audiovizive, media sociale e SIGAL UNIQA, kanali ynë në 'Youtube', dhe 'Google business'. Fokusi ndaj produktit të Pensionit Privat vazhdoi përgjatë gjithë vitit.

Marketimi në fokus i produkteve të Shëndetit Privat

Një fokus i veçantë i fushatës së marketingut për vitin 2019 ishte mbi të gjitha produktet dhe shërbimet e shëndetit me video, banera, artikuj dhe informacion përshkrimor mbi sigurimin privat të shëndetit si e vetmja mundësi për mbulimin 100% të kostove financiare që duhet të përballojë çdo individ një rast aksidenti apo sëmundje të papritur; paketat individuale dhe familjare të sigurimit të shëndetit, të cilat ofrojnë mbulimin e ekzaminimeve shëndetësore duke filluar nga check up-i rutinë vjetor; trajtimet mjekësore në rast sëmundje apo aksidenti, si dhe shpenzimet një rast ndjekje të shtatzanisë në spitalet private brenda dhe jashtë Shqipërisë. Për më tepër, një vëmendje



të veçantë morën në nivel lokal Kartat e Kujdesit Shëndetësor të SIGAL UNIQA të mundësuar në bashkëpunim me Spitalin Continental ne Tirancë dhe në Lushnje, Kliniken Intermedica në Sarandë dhe Klinikën Kristi në Korcë.

Shorteu live i SIGAL UNIQA me rastin e 20-Vjetorit të SIGAL UNIQA

Me rastin e 20-Vjetorit të kompanisë, SIGAL UNIQA hodhi një shorte për të gjithë klientët e saj - një makinë Toyota Yaris Hybrid. Shorteu u hap më 7 mars dhe përfundoi më datë 25 mars. Të gjithë klientët që gjatë kësaj kohe blenë një apo më shumë siguracione me vlerë mbi 5 mijë lekë të reja në një nga zyrat e SIGAL UNIQA në të gjithë Shqipërinë, u bënë automatikisht pjesë e shorteut. Shorteu u hodh më datë 25 mars ora 20:45 live në TV Ora News, në praninë e përfaqësuesve të Ministrisë së Financës, Autoritetit të Lojrade të Fatit, Drejtorisë së Tatimeve, të një Noteri dhe Përfaqësuesve të Kompanisë SIGAL UNIQA. Fituese e këtij shorteu u shpall Kompania "Weatherford" në qytetin e Fierit, e cila kishte blerë siguracionin e shëndetit privat për të gjithë punonjësit e saj. Bileta fituese u tërroq nga imazhi zyrtar i SIGAL UNIQA ndër vite, Nderi i Kombit, Z. Reshat Arbana.

# PËRGJEGJËSIA SOCIALE

## MBËSHTESIM AKTIVITETET SPORTIVE

SIGAL UNIQA mbështet MOTO FEST 2019

SIGAL UNIQA mbështeti edhe këtë vit spektaklin e garave me motorë "Motofest". Moto fest zhvillohet çdo vit duke mbledhur të gjithë dashamirësit e Harley Davidson dhe muzikës rrok. Por ndryshe nga vitet e mëparshme, përherë të parë u organizua në Shqipëri një tubim ndërkontëtar motorësh, ku 130 motoristë nga e gjithë Evropa, iu bashkuan motoristëve tanë nga të gjitha trevat Shqiptare.

Bike Fest 2019 në Shkodër dhe sponsor të Çiklistëve të rinj të Vllaznisë

Të apacionuarit pas motorrave zhvilluan në Shkoder në datat 7-8 qershor paradën e motorrave dhe një koncert në pedonalen e qyrtetit të Shkodrës. SIGAL do të vazhdojë të mbështesë të gjitha zhanret e sporteve pasi, gjithmonë SIGAL ka qenë promotore e sporteve dhe nxitëse tek të rinjtë, për t'i orientuar drejt aktivitetit fizik si dhe zhvillimin e sportit në tërsësi, në të gjithë rajonin. Prandaj dhe SIGAL ka sponsorizuar Çiklistët e rinj të klubit Vllaznia, me qëllim motivimin dhe mbështetjen e këtyre të rinjve të talentuar. Çiklistët e ekipit të Vllaznisë shpallën më të mirët e ditës së parë të kupës "AgimTafili" me itinerar Tiranë - Shkodër.

Sporti përmirëson shëndetin

SIGAL UNIQA Kosova ka organizuar aktivitete sportive në futboll me degët. Sporti është një përbërës integral i jetës sonë të përditshme përvlerat që ai mban për shëndetin tonë mendor, fizik dhe ndihmon në ndërtimin e gjendjes shpirtërore dhe marrëdhënieve në punë. SIGAL UNIQA mbështet dhe vazhdon të mbështesë ekipet lokale të sportit. 7 ekipe ose 63 lojtarë nga ekipet e "Prishtina" "Gjakova", "Prizren", "Mitrovica", "Ferizaj", "Prishtina HQ-LIFE" dhe ekipet "Prishtina HQ" morën pjesë në këtë turne.

Fundjavat 3x3 StreetBasket

Nën kujdesin e veçantë të Z. Avni Ponari, Drejtor i Përgjithshëm i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA dhe në bashkëpunim me Federatën Shqiptare të Basketbollit,



u organizua në Tiranë Kampionati "StreetBasket 3X3" me pjesëmarrjen e gjerë të shumë të rinje të apasionuar pas basketbollit.

Rikthehet bashkëpunimi i suksesshëm - Kompania "SIGAL UNIQA Group AUSTRIA" & Klubit i Basketbollit "SIGAL PRISHTINA"

Me rastin e rivendosjes së bashkëpunimit më të suksesshëm në historinë e sportit në Kosovë, ndërmjet Kompanisë "SIGAL UNIQA Group AUSTRIA" dhe Klubit të Basketbollit "SIGAL Prishtina", Drejtori i Përgjithshëm i Kompanisë "SIGAL UNIQA Group AUSTRIA" në Shqipëri, Kosovë dhe Maqedoninë e Veriut, Z. Avni Ponari, organizoi më 30 shtator 2019 një prite për të festuar këtë vazhdimësi të suseshme bashkëpunimi si edhe për një fillim të mbarë të etapës së dytë të këtij bashkëpunimi që u kurorëzua me triumfin e Klubit në Superkupën e Kosovës për vitin 2019.

Klubi i Basketbollit "SIGAL Prishtina" është Klubi më i madh i basketbollit në Kosovë. Ky klub ka garuar rregullisht në nivelet më të larta të basketbollit në Kosovë dhe në nivel ndërkontëtar. Që prej vitit 1999, Klubi ka arritur sukses të jashtëzakonshëm në basketbollin vendor: 13 herë Kampion i Kosovës, 15 herë fitues i Kupës së Kosovës, 3 herë fitues i Supërkupës dhe 2 herë fitues i Ligës BIBL. Në rrafshin ndërkontëtar, "SIGAL PRISHTINA", ka shënuar suksesin më të madh duke u kualifikuar në 16 klubet më të mira në Kupën Evropiane FIBA.

Gjithmonë në mbështetje të Kombëtares KUQ & Zi SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sponsor Zyrtar i Kombëtares Shqiptare të Futbollit!

## MBËSHTESIM TRASHËGIMINË KULTURORE

Sponsorizimi i Guidës së Bregdetit Shqiptar SIGAL UNIQA ka qenë gjithmonë një nga promovuesit kryesorë të Shqipërisë dhe një nismë tjetër ka qenë sponsorizimi i guidës së rivierës shqiptare.

Manifestimi "Tingujt e Çarshisë" mbështetet nga UNIQA Maqedoni

Nga 16 shtatori deri 18 shtator 2019 në pjesën e vjetër të qytetit të Shkupit në Çarshinë e vjetër si dhe në Sheshin Filipi II u mbajt manifestimi tradicional i 13-të me rradhë "Tingujt e Çarshisë". Sipas Qendrës Informative Kulturore-Shkup, e cila ishte organizatore e këtij evenimenti. Qëllimi i manifestimit është që përmes

koncerteve të të gjitha zhanreve, performancat folklorike, poezisë, kolonive të artit dhe prezantimit të zanatave të vjetra Çarshia të ringjallet në fryshtën e traditës si përkujtues kulturor dhe shpirtëror i qytetit.

### MBËSHTESIM ARTIN DHE KULTURËN

Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL mirëpret me dhjetëra artistë gjatë vitit 2019


Klubi i Artit dhe Kulturës SIGAL, që prej themelimit është kthyer në shtëpinë e qindra artistëve të rinj dhe të vjetër, të cilët zhvillojnë aktivitetet e tyre artistike në ambientet e këtij klubit tërësisht falas. Misioni i Klubit të Artit dhe Kulturës SIGAL është që të promovojmë kulturën kombëtare, të rrisnim ndërgjegjen për trashëgiminë kulturore të kombit tonë dhe të ndihmojë në promovimin dhe zhvillimin e talenteve të reja. Mesatarisht çdo muaj zhvillohen 4 aktivitete në ambientet e Klubit. Përgjatë viti 2019 u zhvilluan një sërë aktivitetesh si: promovim librash, koncerthe artistike me artistë të rritur por edhe me nxënësit e talentuar të shkollës "Jani Kukuzeli", aktivitete sociale të fëmijëve etj.

Eksposita "UNIQ'Art", SIGAL UNIQA hap dyert për publikun

Në kuadër të çeljeve të festimeve të 20 vjetorit të themelimit të SIGAL UNIQA, u çel në ambientet e zyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të SIGAL UNIQA eksposita UNIQ'Art. SIGAL UNIQA i ktheu ambientet e saj në një ekspositë të hapur për publikun, ku piktorët më të njohur shqiptarë realizuan piktura me tematikë: rritje, zhvillim, vizion, falënderim, pikërisht ashtu siç identifikohet edhe vetë SIGAL-i. Mbi 100 punime nga piktorët më të shquar shqiptarë qëndruan në ambientet e SIGAL Business Center nga data 25 shkurt deri me 25 Mars 2019. Caush Vathi me "Peisazh" me votat e vizitorëve dhe Shpresa Milaqi me "Vazo me lule" me votat e ndjekësve në rrjetet sociale ishin fituesit e EKSPozites UNIQ'Art.

SIGAL UNIQA në mbështetje të artit dhe letërsisë "Austro-Hungaria dhe Shqipëria 1916-1918", ishte libri i promovuar në Muzeun Historik Kombëtar, i cili u mbështet nga SIGAL UNIQA dhe Ambasada Austriake në Shqipëri. Në këtë libër përmblidhen 20 kumtesa që përfshijnë kontributet austriake në Shqipëri.

Koncerthe të Orkestrës së Harqeve SIGAL UNIQA Orkestra e Harqeve SIGAL UNIQA performoi një koncert të mrekullueshmër në 20-vjetorin e themelimit



të SIGAL. Të udhëhequr nga Mjeshtri i madh z. Ermir Dizdari orkestra e përbërë nga 15 instrumentiste profesioniste luajti kryeveprat e kompozitoreve më të mëdhenj të huaj dhe shqiptarë. Gjithashtu Orkestra e Harqeve e SIGAL UNIQA, organizoi koncertin e rradhës në Panairin Food & Drink 2019 në Expocity Albania. Gjatë gjithë muajit maj dhe qershori Klubi i Artit dhe Kulturës ka zhvilluar aktivitete të ndryshme artistike si: Festivali Ndërkombëtar i Muzikës së Dhomës, "Skena Verore Ulqin" dhe koncert në qytetin e Lezhës, me rastin e 575-Vjetorit të Kuvendit të Lezhës.

SIGAL UNIQA mbështet Ballon Vjeneze 2019 Balloja Vjeneze, një spektakël klasi dhe elegancë në ritmin e valshit të mrekullueshmër Vjenez, u zhvillua mbrëmjen e së premtes, 12 Prill 2019, në Pallatine Kongreseve, duke mbledhur bashkë miq Shqiptarë dhe Austriake, personalitetë, njerëz të biznesit, artistë dhe çdo qytetar që ka pikë të dobët muzikën klasike dhe valsin vjenez. Me mbështetjen e SIGAL UNIQA Group Austria, ky edicion i Ballos Vjeneze në Tiranë konsolidoi një traditë të mrekullueshme, prezante në metropolet më të rëndësishme të botës.

Koncerti Final, Shostakovich/Beethoven u mbështet nga SIGAL

SIGAL UNIQA mbështetësja kryesore e artit në Shqipëri solli "Koncertin Final – Shostavich/Beethoven" me tre artistë të veçantë së bashku: Mayu Kishima nga Japonia, fituese e shumë çmimeve ndërkombëtare si "Isaac Stern", "Queen Elisabeth" apo Çajkovski", Vlorent Xhafaj, një prej muzikantëve shqiptarë më aktivë në skenën kombëtare dhe ndërkombëtare, prej 20 vitesh në Francë, dhe Varduhu Yeritsyan, pianiste e shkëlqyer soliste dhe pedagoge në Konservatorin Superior të Parisit.

UNIQA Maqedoni mbështet festivalin "Skupi 2019" Festivali folklorik ndërkombëtar "Skupi 2019" këtë vit u organizua edicionin e 13-të me pjesëmarrje të shteteve: Maqedonia e Veriut, Kosova, Shqipëria, Sllovakia, Kroacia, Turqia, Kirgistani dhe Qiproja Veriore.

### Mbështesim projektet shëndetësore

Klinika Lëvizëse SIGAL shkon në Bogë

Boga, fshati midis maleve në Malësinë e Madhe, ishte destinacioni i rradhës i Klinikës Lëvizëse "SIGAL UNIQA". Në 20-22 qershor, stafi i kualifikuar mjekësorë dhe pajisjet moderne të Klinikës "SIGAL" i mundësuan

banorëve të kësaj zone të thellë të kryenin vizita dhe të merrnin shërbime mjekësore falas. SIGAL UNIQA Group Austria e ka kthyer tashmë në traditë ofrimin e shërbimit mjekësore për banorët e zonave rurale por edhe të qyteteve të ndryshime, me qëllimim ndërgjegjësimin e tyre për kryerjen e vazhdueshme të kontolleve mjekësore, me moton: "Është më mirë të parandaloshë një sëmundje sesa ta kurosh atë".

Klinika lëvizëse SIGAL UNIQA në Lumas, Berat SIGAL UNIQA vijoi turin në zonat rurale të Shqipërisë në fshatin Lumas, në Berat ndërmjet datave 27-28 shtator 2019. Klinika Lëvizëse ofroi ekzaminime shëndetësore falas për rrith 100 banorë në ditë.

Klinika Lëvizëse Mjekësore SIGAL UNIQA në bashkëpunim me WPSAlbania, ishte në Tropojë ndërmjet datave 16-17-18 tetor 2019. Klinika Lëvizëse ofroi ekzaminime shëndetësore pa pagesë. Z. Avni Ponari, Drejtë i Pergjithshem i SIGAL UNIQA Group AUSTRIA ishte në Bajram Curri, ku ndoqi nga afër Klinikën Lëvizëse SIGAL UNIQA në kuadër të muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit. Mbi 250 gra dhe vajza u ekzaminuan pa pagesë.

Klinika Lëvizëse Mjekësore SIGAL UNIQA në kuadër të 'Muajit të ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit', ishte në fshatin Dobraç të Shkodrës, datë 29 tetor 2019.


Klinika Lëvizëse Mjekësore SIGAL UNIQA në kuadër të 'Muajit të ndërgjegjësimit për kancerin

e gjirit', do të jetë në Fshatin Bërdicë të Shkodrës, datë 30 tetor 2019.

Mbyllëm "Muajin e ndërgjegjësimit për kancerin e gjirit" me pjesëmarrjen e Klinikës Lëvizëse Mjekësore SIGAL UNIQA në Edicionin e II-të të Panairit "CCIT Expo Medical.al", me fokus të veçantë mbi kujdesin shëndetësor parësor, ndërmjet datave 31 tetor – 2 nëntor 2019, në Pallatin e Kongreseve, Tiranë. Edhe përgjatë këtyre tre ditëve Klinika Lëvizëse ofroi ekzaminime shëndetësore pa pagesë.

#### MBËSHTESIM EDUKIMIN DHE PUNËSIMIN

Pjesëmarrës në panairet e punës Gjatë gjithë muajit maj SIGAL ka që pjesë e panairëve të rendësishme pune si:



Panari Work and Study, ky një panar i ri organizuar nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë për t'i të dhënë mundësi të rinxje të aplikojnë për punën në kompanitë më të mira në vend.

Panairi i punës Open Day, Universiteti Europian i Tiranës i cilin është konceptuar si një tërësi aktivitetesh, të cilat synojnë të vendosë lidhje ndërmjet studentëve të UET dhe tregut të punës, në të cilin kompani si SIGAL UNIQA luan një rol të rëndësishëm.

Platforma më e re "SIGAL Audiobooks.al" SIGAL UNIQA sjell platformën e parë dixhitale për dëgimin e librave audio në Shqip – [www.audiobooks.al](http://www.audiobooks.al). Gjithashtu në këtë platformë mund të dëgjojnë infomacione për të gjitha produketet e sigurimit, si të veprohet në rast dëmi dhe kuriozitete të tjera për sigurimet. Qëllimi platformës është të informojnë individët për sigurimet dhe blerjen e produkteve online në një qasje ndryshe.

## PRODUKTET DHE SHËRBIMET TË NJË VLERE TË SHTUAR


**Ne jemi aty për klientët tanë kudo ku ata kanë nevojë për ne!**

Ne jemi fuqimisht të fokusuar dhe të angazhuar për t'i sjellë produktet dhe shërbimet tona përmes aksesit dixhital në kohë reale, sa më thjeshtë dhe me një klikim për të gjithë klientët tanë kudo ku ndodhen. Objktivi ynë është që të investojmë për klientët tanë në teknologjitet dixhitale për të cilat ne besojmë se do t'i bëjë shërbimet tona më të shpejtja dhe më eficiente. Për të arritur këtë ne jemi vigjilentë ndaj të gjitha tendencave potenciale të reja të tregut duke i garantuar klientëve tanë trapolinën teknologjike të së ardhmes. Ne punojmë me një ekip të dedikuar dixhital vetëm për këtë qëllim. Ata janë frontiera jone drejt së ardhmes tonë të përbashkët dixhitale. Vizioni dhe modeli ynë përkon me ambicjen tonë drejt suksesit. Ne kemi filluar që të shkelim në këtë rrugë të përbashkët duke prezantuar:

SIGAL UNIQA me produkt të ri për shëndetin Duke patur në vëmendje kërkesat dhe nevojat e klientëve kudo ku ata kanë nevojë për Shqipërisë, SIGAL UNIQA ofron një produkt të ri shëndeti, i cili lehtëson marrjen e shërbimeve shëndetësore në klinikat e qyteteve ku jetojnë klientët tanë. Që prej muajit mars, SIGAL UNIQA ofron një kartë sigurimi të posaçme, që klientët që e blejnë ose anëtarët e familjes së tyre, PAVARESISHT MOSHES, mund t'i kryejnë analizat dhe shërbimet e tjera mjekësore në klinika dhe spitale private aty ku jetoni. "Karta e Kujdesit shëndetësor në qytetin tim" kështu quhet karta e re e shëndetit të SIGAL UNIQA dhe kushton vetëm 2,500 lekë të reja.

Paketa e sigurimit "Jetë Plus"

Përmes këtij sigurimi mbulohen shpenzimet mjekësore në rast diagnostikimi me një sëmundje kritike dhe trajtimi në spitalet më të mira jashtë Shqipërisë.



SIGAL UNIQA bën realitet Telemjekësinë me shërbimin më të ri "Telefono një Mjek"

"Telefono një mjek" është një aplikacion për telefon celular android dhe iphone, i cili nëse shkarkohet në telefonin tuaj, ju mundëson të komunikoni 24/7 me mjekë të përgjithshëm për çdo ankesë që mund të keni.

## PËRGJEGJËSIA KONTRAKTUALE

### KATASTROFAT NATYRORE SHQIPËRIA GODITET NGA DY TËRMETE SHKATËRUESE

Më 21 shtator 2019, Shqipëria, kryesisht qytetet Tiranë, Durrës dhe Elbasan u goditën nga një tërmet i magnitudës 5.8 i shkallës richter me epikendër në detin Adriatik dhe me intensitet 7.5 ballë, më i fuqishmi në 30 vitet e fundit duke shkaktuar panik, frikë dhe pasiguri tek qytetarët e këtyre qyteteve, i cili u pasua nga një seri e njëpasnjëshme goditjesh në tre ditët në vijim. Për pasojë, në të gjithë vendin mbetën të dëmtuara me qindra shtëpi, pallate, institucionë publike dhe biznese duke shkaktuar plasaritje, krisje ose çarje të mureve pallateve, por fatmirësisht pa asnjë shembje totale apo dëmtim serioz në strukturat e këtyre pallateve. Dëmtime pësuan edhe gjeneratorët e infrastrukturës së energjisë elektrike duke shkaktuar ndërprerjen e furnizimit me energji. Si të mos mjaftonin të gjitha këto, një faktor tjetër natyror që e përkeqësoi më shumë këtë gjendje ishin gjithashtu shrat e rrëmbyer duke shkaktuar përblytje masive dhe dëme shtesë.

Mbi 260 dëme, riparime dhe/ose dëmshpërblime të raportuara të klientëve

Dy javë pas tërmetit, SIGAL UNIQA Group AUSTRIA regjistroi në total mbi 260 raste dëmshëm të raportuara nga klientët e saj, me një rezervë fondi prej 3.5 milionë euro, nga të cilat 190-200 raste ishin banesa, ndërsa pjesa tjetër institucionë publike dhe biznese në Tiranë, Durrës, përgjatë autostradës Tiranë-Durrës dhe në Elbasan. Procesi i vlerësimit përfundimtar dhe përpunimi i këtyre dëmeve deri në dëmshpërblimin e tyre finansiar u krye me rigorizitet në kohë rekordh dhe në përputhje me të gjitha kushtet kontraktuale. Për t'iu gjendur pranë dhe për t'i mbështetur financiarisht klientët e saj, SIGAL UNIQA mobilizo dhe zbriti në terren menjëherë pas ngjarjes tre ekipe dhe dhjetra punonjës të specializuar inxhinierësh dhe vlerësuesish dëmesh. Dëmet ishin kryesisht krisje/çarje të mureve, dëme në

përbajtje të ndërtesave dhe në inventarin e pajisjeve të shtëpive ku shumica prej tyre ishin dëme sipërfaqësore.

SIGAL UNIQA ka kryer me profesionalizmin maksimal, me korrekësi, eficiencë dhe në kohë reale, dëmshpërblimin e 100% të këtyre rasteve në përbushje të përgjegjësive dhe detyrimeve kontraktuale të SIGAL UNIQA duke i ardhur sa më shpejt që të ishte e mundur në ndihmë dhe mbështetje klientëve tanë të cilët na kanë besuar jetën, shëndetin, pronat, dhe automjetet e tyre.

Më 26 nëntor 2019, Shqipëria, u godit nga një tërmet i dytë me magnitudë 6.4 me epikendër në detin Adriatik që shkaktoi 51 të vdekur dhe 1 miliard dëme dhe i pasuar nga mbi 2,000 post-tërmete në të gjithë vendin. Kompania SIGAL UNIQA Group AUSTRIA u gjend pranë të gjithë klientët e saj që kishin siguruar shtëpitë dhe/ose bizneset e tyre me SIGAL UNIQA se, bazuar në kushtet e kontratës së sigurimit se, ishte detyra dhe përgjegjësia jonë ligjore për të garuar ekzekutimin e dëmshpërblimit të të gjitha detyrimeve tona kontraktuale dhe ligjore ndaj çdo klienti individual të siguruar me kompaninë tonë për të ndihmuar e mbështetur klientët tanë në kohë reale 24/7.

Mbi 2,000 dëme, riparime dhe/ose dëmshpërblime të raportuara të klientëve të cilat në total arrijnë vlerën prej 12 milionë euro.

Nevoja për t'u siguruar

Tregu i sigurimeve është një nga tre shtyllat e zhvillimit të vendit dhe ndoshta më e rendësishmja pasi gjeneron likuiditete dhe frysëmarrje financiare nëpërmjet mbrojtjes financiare që garanton. Gjithashtu, sigurimet përbëjnë edhe investitorin më të madh të një vendi duke shërbuer si garantuesi i të gjithë financimeve pasi kushdo që ka ndërmend të investojë në Shqipëri në fillim informohet mbi legjislacionin e më pas për sigurimin e investimit.

# TREGU I SIGURIMEVE NË RAJON

**SHQIPËRI**


## Tregu i sigurimeve jo-jetë

Tregu i sigurimeve të jo-jetës, në të cilin operojnë 8 kompani, u udhëhoq nga SIGAL UNIQA e cila zotëroi 25.88 % të tregut. SIGAL UNIQA renditet gjithashtu e para edhe për pagesën e dëmeve duke paguar 34.83 % të dëmeve.




## Tregu i sigurimeve të jetës

Që prej disa vjetësh, në tregun shqiptar të sigurimeve të jetës operojnë 4 kompani sigurimi. Edhe për vitin 2019 tregu u udhëhoq nga SIGAL Life UNIQA me 59.51% e cila ka paguar 47.47% të dëmeve të ndodhura në treg.



## Tregu i pensioneve private

Gjatë vitit 2019, në tregun e pensioneve operuan 3 fonde pensionesh private. Fondi i Pensioneve SIGAL udhëhoqi tregun si për vlerën e aseteve neto (45.68%).



**KOSOVË**


## Tregu i sigurimeve jo-jetë

Në tregun kosovar operojnë 12 kompani sigurimi ndër të cilat SIGAL UNIQA Kosova renditet e dyta me rreth 12.28% të tregut për volumin e primeve si dhe ka paguar 10.14% të dëmeve totale të tregut.



## Tregu i sigurimeve të jetës


Në tregun kosovar të sigurimeve të jetës operojnë 2 kompani ndër të cilat SIGAL Life UNIQA Kosova renditet e dyta me 32.31% të tregut për volumin e primeve dhe ka paguar 26.51% të dëmeve.



**MAQEDONI**


## Tregu i sigurimeve jo-jetë

Në tregun maqedonas të sigurimeve të jo-jetës operojnë 11 kompani. UNIQA a.d. u rendit në vendin e gjashta për nga volumi i primeve të shkruara (8.54%).




## Tregu i sigurimeve të jetës

UNIQA Life renditet e treta në tregun maqedonas të sigurimeve të jetës (11.26%) në të cilin operojnë 5 kompani.




# TË DHËNA FINANCIARE

Grupi SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA  
Prime të shkruara për katër vitet e fundit (në euro)



Kompania	2016 (në Euro)	2017 (në Euro)	2018 (në Euro)	2019 (në Euro)
SIGAL UNIQA AL Jo-Jetë dhe Risigurime	29,193,000	29,664,042	32,247,000	<b>34,899,661</b>
SIGAL Life UNIQA AL	4,249,000	5,476,588	5,314,000	<b>5,884,561</b>
SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA	1,681,000	1,461,529	2,088,000	<b>2,124,432</b>
SIGAL UNIQA KS Jo-Jetë	10,501,000	9,559,338	10,509,000	<b>12,034,619</b>
SIGAL Life UNIQA KS	762,000	636,650	856,000	<b>1,116,295</b>
UNIQA MK Jo-Jetë	11,323,000	11,345,015	13,054,000	<b>13,384,976</b>
UNIQA Life MK	1,170,000	1,405,624	1,583,000	<b>2,403,932</b>
<b>GRUPI</b>	<b>58,879,000</b>	<b>59,548,838</b>	<b>65,652,000</b>	<b>71,848,476</b>

Prime të shkruara sipas produktave për vitin 2019



Lloji i Produktit	AL (në Euro)	KS (në Euro)	MK (në Euro)	Grupi (në Euro)
Pasuri	9,783,197	1,687,968	2,948,580	<b>14,419,745</b>
Motorike	21,041,517	7,789,798	9,037,464	<b>37,868,779</b>
Jetë, Shëndet dhe Aksidente	9,434,267	3,673,148	3,802,864	<b>16,910,279</b>
Pensione Vullnetare*	2,124,432	-	-	<b>2,124,432</b>
Risigurime*	525,241	-	-	<b>525,241</b>
<b>TOTALI</b>	<b>42,908,654</b>	<b>13,150,914</b>	<b>15,788,908</b>	<b>71,848,476</b>

\* Produktet e Pensioneve vullnetare dhe Risigurimet ofrohen vetëm në Shqipëri përkatësisht nga kompanitë SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Risigurime dhe SH.A.F.P SIGAL Life UNIQA.

# RAPORTI I AUDITUESVE TE PAVARUR

SIGAL UNIQA Group AUSTRIA sh.a.

Pasqyrat Financiare të Konsoliduara sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar per vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019

## Raporti i Audituesit të Pavarur

Për aksionarët e Sigal Uniqa Group Austria sh.a.

Opinioni

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të konsoliduara të Sigal Uniqa Group Austria sh.a (“Grupi”), të cilat përfshijnë pasqyrën e konsoliduar të pozicionit financiar më datë 31 dhjetor 2019, pasqyrën e konsoliduar të fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithpërfshirëse, pasqyrën e konsoliduar të ndryshimeve në kapital dhe pasqyrën e konsoliduar të flukseve të parasë për vitin që mbyllet më këtë datë, si edhe shënimet për pasqyrat e konsoliduara financiare, përfshirë një përbledhje të politikave kontabël më të rëndësishme.

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare të konsoliduara bashkëlidhur paraqesin drejt, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financier të Grupit më datën 31 dhjetor 2019, dhe performancën financiare dhe flukset e parashë për vitin që mbylli let në këtë datë, në përpjekje me Standartet Ndërkontinentare të Raportimit Financiar (SNRF).

Baza për Opinionin

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombe të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitet tona sipas këtyre standardeve janë pëershruar në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit ku jepen *Përgjegjësitet e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare të Konsoliduara*. Ne jemi të pavarur nga Grupi në përputhje me Kodin e Etikës të Kontabilistëve Profesioniste të njohur nga Bordi Ndërkombe i Etikave Standarde për Kontabilistët (IESBA), kërkosat etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare në Shqipëri, si dhe kemi përmbrushur përgjegjësitet e tjera etike në përputhje me kodin IESBA. Ne besojmë se evidanca e auditimit që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë një bazë për opinionin tonë.

## Çështje të Tjera

Pasqyrat financiare të konsoliduara të Grupit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018 u audituan nga një auditore tjetër i cili shprehu një opinion pa rezervë mbi ato pasqyra financiare të konsoliduara më 31 maj 2019.

*Përgjegjësítë e Drejtimit dhe të Personave të Ngarkuar me Qeverisjen në lidhje me Pasqyrat Financiare Të konsoliduara*

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare të konsoliduara në përputhje me SNRF-të, dhe për ato kontolle të brendshme që drejtimi i gjykon të nevojshme për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare të konsoliduara që nuk përbajnë anomali materiale, qoftë për shkak të mashtimit apo gabimit.

Në përgatitjen e pasqyrave financiare, drejtimi është përgjegjës për të vlerësuar aftësinë e Grupit për të vazhduar në vijimësi, duke dhënë informacion, nëse është e zbatueshme, për çështjet që kanë të bëjnë me vijimësinë dhe duke përdorur parimin kontabël të vijimësisë përveç se në rastin kur drejtimi synon ta likujdojë Shoqërinë ose të ndërpresë aktivitetet, ose nëse nuk ka alternativë tjeter reale përveç sa më sipër.

Ata që janë të ngarkuar me qeverisjen janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të Grupit.

## **Përgjegjësitë e Audituesit për Auditimin e Pasqyrave Financiare Të konsoliduara**

Objektivat tona janë që të arrijmë një siguri të arsyeshme lidhur me faktin nëse pasqyrat financiare të konsoliduara në tërësi nuk kanë anomali materiale, për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të lëshojmë një raport auditimi që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme është një siguri e nivelit të lartë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer sipas SNA-ve do të identifikojë gjithmonë një anomali materiale kur ajo ekziston.

Anomalitë mund të vijnë si rezultat i gabimit ose i mashtimit dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose të marra së bashku, pritet që në mënyrë të arësyeshme të influencojnë vendimet ekonomike të përdoruesve, të marra bazuar në këto pasqyra financiare të konsoliduara.

Si pjesë e një auditimi në përputhje me SNA-të, ne ushtrojme gjykim dhe skepticizëm profesional gjatë procesit të auditimit. Ne gjithashtu:

- identifikojmë dhe vlerësojmë rreziqet e anomalive materiale në pasqyrat financiare të konsoliduara, për shkak të gabimeve ose mashtrimeve, projektojmë dhe zbatojmë procedura auditimi të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, si edhe marrim evidenca auditimi të plota dhe të mjaftueshme për të krijuar bazat e opinionit tonë. Rreziku i mosbulimit të një gabimi material që vjen si rezultat i një mashtimi, është më i lartë se ai që vjen nga një gabim, pasi mashtimi mund të përfshijë marrëveshje të fshehta, falsifikime, mosveprime të qëllimshme, keqinterpretim, ose shkelje të kontolleve të brendshme.
  - marrim një kuptueshmëri të kontrollit të brendshëm në lidhje me auditimin, për të planifikuar procedura të përshtatshme në varësi të rrethanave, dhe jo për të shprehur një opinionin mbi efektshmérinë e kontolleve të brendshme të entitetit.
  - vlerësojmë konformitetin e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmérinë e vlerësimeve kontabël dhe informacioneve shpjeguese të bëra nga drejtimi.
  - konkludojmë mbi përdorimin e duhur te parimit kontabël të vijimësë nga drejtimi si dhe, bazuar në evidencat e marra gjatë auditimit, konkludojmë nëse ekziston një pasiguri materiale e lidhur me ngjarje ose kushte të cilat mund të sjellin dyshime në aftësinë e entitetit për të vazhduar në vijimësi. Nëse konkludojme që ekziston një pasiguri materiale, ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin tonë të auditimit për informacionet shpjeguese përkatëse në pasqyrat financiare ose, nëse keto informacione shpjeguese janë të pamjaftueshme, të modifikojmë opinionin tonë. Përfundimet tonë janë të bazuara në evidencat e auditimit të marra deri në ditën e raportit tonë të audituesit. Megjithatë, ngjarjet ose kushtet e ardhshme mund të jenë shkak që entiteti të ndalojë së vazhduar në vijimësi.
  - vlerësojmë prezantimin e përgjithshëm, strukturën dhe përbajtjen e pasqyrave financiare, përfshirë dhënien e informacioneve shpjeguese, dhe nëse pasqyrat financiare paraqesin transaksionet dhe ngjarjet bazë në mënyrë të atillë që të arrinë një prezantim të drejtë.
  - Marrim evidencë të mjaftueshme të auditimit të duhur në lidhje me informacionin financiar të njësive ekonomike ose aktiviteteve të biznesit brenda Grupit për të shprehur një opinion mbi pasqyrat financiare të konsoliduara. Ne jemi përgjegjës për kryerjen e auditimit të Grupit. Ne mbetemi përgjegjës vetëm për opinionin tonë të auditimit.

Ne komunikojme me ata të cilët janë të ngarkuar me qeverisjen, midis çështjesh të tjera, për qëllimin e kohën e planifikuar të auditimit, gjetjet e rëndësishme gjatë auditimit, përfshirë çdo mangësi të heksuar në kontrollin e brëndshëm të cilat ne i identifikojmë gjatë procesit të auditimit.

**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.****Pasqyra e konsoliduar e pozicionit finançar më 31 dhjetor 2019**

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)

	Shënie	31 dhjetor 2019	31 dhjetor 2018
<b>AKTIVET</b>			
Mjete monetare dhe ekuivalentët e tyre	9	326,373	375,496
Depozita me afat	10	8,403,860	7,712,143
Investime në letra me vlerë	11	1,755,236	1,700,263
Llogari të arkëtueshme nga sigurimi dhe të arkëtueshme të tjera	12	1,490,486	1,485,371
Aktive të risigurimit	13	2,677,421	1,329,942
Shpenzimet e shtyra të marrjes në sigurim	14	759,715	718,329
Aktive afatgjata materiale	15	1,750,715	1,166,501
Tatim fitimi i arkëtueshëm		44,919	59,235
Aktive të tjera	16	311,295	248,733
<b>TOTALI AKTIVEVE</b>		<b>17,520,020</b>	<b>14,796,013</b>
<b>DETÝRIMET</b>			
Detyrimet për humbje dhe shpenzimet për rregullimin e humbjes	17	5,965,197	4,401,087
Rezerva të tjera	17	1,484,740	1,239,958
Rezervat për primin e pafituar	18	4,297,976	3,938,128
Detyrime të tatimit mbi fitimin		3,235	3,436
Detyrime nga sigurimet dhe risigurimet	19	686,245	578,942
Detyrime të tjera	20	759,047	352,642
<b>TOTAL I DETÝRIMEVE</b>		<b>13,196,440</b>	<b>10,514,193</b>
<b>KAPITALI</b>			
Kapitali themeltar	21	2,232,909	2,232,909
Rezerva të tjera të kapitalit		52,133	52,133
Rezerva të rrezikut të sigurimit	22	589,996	581,774
Rezerva të konvertimit		(195,551)	(178,148)
Rezerva rivlëresimi		148,688	-
Fitime të mbartura		1,465,635	1,573,208
Totali i kapitalit që i atribuohet pronarëve të shoqërisë mëmë		4,293,810	4,261,876
Interesi jo-kontrollues		29,770	19,944
<b>TOTALI KAPITALIT</b>		<b>4,323,580</b>	<b>4,281,820</b>
<b>TOTALI KAPITALIT DHE DETÝRIMEVE</b>		<b>17,520,020</b>	<b>14,796,013</b>

Këto pasqyrat financiare të konsoliduara janë aprovuar nga drejtuesit e grupit më 30 qershor 2020 dhe janë firmosur nga:



  
Klement Mersini  
Drejtësor Finance

**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.****Pasqyra e konsoliduar e fitimit ose humbjes dhe të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse**

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)

	Shënie	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<b>Prime të shkruara bruto</b>			
Prime të ceduara në risigurim	23	8,573,653	8,108,503
<b>Prime bruto të fituara</b>	<b>24</b>	<b>(1,038,232)</b>	<b>(1,078,913)</b>
<b>7,535,421</b>	<b>7,029,590</b>		
Ndryshimi në rezervën për prime të papërfituar			
Ndryshimi në risigurim në rezervat e primeve të pafituar	13	128,289	(17,985)
<b>Të ardhura neto nga primet</b>	<b>7,223,737</b>	<b>6,740,800</b>	
Të ardhura nga investimet		121,395	148,308
Të ardhura të tjera	25	222,337	227,445
<b>7,567,469</b>	<b>7,116,553</b>		
Ndryshimi në rezerva të tjera			
Ndryshimi në pjesëmarrjen e risigurimit ne rezervën e dëmeve		1,915,906	(3,521)
Dëme dhe shpenzime nga rregullimi i humbjeve	17	(5,117,008)	(2,549,052)
<b>Dëme të sigurimit neto</b>	<b>(3,389,624)</b>	<b>(2,667,401)</b>	
Kostot e marrjes në sigurim	26	(1,580,366)	(1,312,710)
Shpenzime administrative dhe marketingu	27	(1,868,781)	(1,959,811)
Shpenzime të tjera sigurimi	28	(413,503)	(439,076)
Shpenzime zhvlerësimi i të arketueshme nga sigurimi dhe të tjera	12, 16	(121,155)	(184,891)
Fitim nga kurset e këmbimit		(36,877)	(187,890)
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>157,163</b>	<b>364,774</b>	
Tatimi mbi fitimin	29	(106,687)	(169,763)
<b>Fitimi i vitit</b>	<b>50,476</b>	<b>195,011</b>	
<b>Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse</b>			
Zérat që janë ose mund të riklasifikohen më pas në fitim ose humbje			
Të ardhura nga rivlerësimi		148,693	-
Operacionet e huaja - diferençat në konvertimet në valutë të huaj		(17,407)	(168,709)
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vitit</b>	<b>181,762</b>	<b>26,302</b>	
<b>Fitimi i atribueshëm për:</b>			
Pronarët e shoqërisë mëmë		40,649	190,007
Interesi jo-kontrollues		9,827	5,004
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të atribueshme për:</b>	<b>171,936</b>	<b>21,265</b>	
Pronarët e shoqërisë mëmë		9,826	5,037
Interesi jo-kontrollues			

**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.****Pasqyra e konsoliduar e ndryshimeve në kapital për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019**

(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)

	Kapitali themeltar	Rezerva Rezervatë kapitalit	Rezerva të Rezervatë sigurimit	...	-	Rezerva të konvertimit	Rezerva rivlerësimi	Fitime të mbartura	Të atribueshme për pronarët e shoqërisë mëmë	Interesi jo-kontrollues	Totali	
<b>Gjendja më 1 janar 2018</b>	2,232,909	52,133	579,595			(9,406)		1,546,380	4,401,611	14,907	4,416,518	
Fitimi i vtit	-	-	-					190,007	190,007	5,004	195,011	
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksat	-	-	-			(168,742)		-	(168,742)	33	(168,709)	
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vtit</b>						(168,742)		190,007	21,265	5,037	26,302	
Përvetësimi i fitimeve të mbartura	-	-	2,179					(2,179)	-	-	-	
Dividendi i paguar	-	-	-					(161,000)	(161,000)	-	(161,000)	
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarja tek pronarët</b>			2,179					(163,179)	(161,000)	-	(161,000)	
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2018</b>	2,232,909	52,133	581,774			(178,148)		1,573,208	4,261,876	19,944	4,281,820	
Fitimi i vtit	-	-	-					40,649	40,649	9,827	50,476	
Rivlerësimi i Aktiveve Financiare	-	-	-					54,506	54,506	5	54,511	
Rivlerësimi i Aktiveve Afatgata	-	-	-					94,182	94,182	-	94,182	
Të ardhura të tjera gjithëpërfshirëse, neto nga taksat	-	-	-			(17,403)		-	(17,403)	(6)	(17,409)	
<b>Totali i të ardhurave gjithëpërfshirëse të vtit</b>						(17,403)		148,688	40,649	171,934	9,826	181,760
Përvetësimi i fitimeve të mbartura	-	-	8,222					(8,222)	-	-	-	
Dividendi i paguar	-	-	-					(140,000)	(140,000)	-	(140,000)	
<b>Totali i kontributeve dhe shpërndarja tek pronarët</b>			8,222					(148,222)	(140,000)	-	(140,000)	
<b>Gjendja më 31 dhjetor 2019</b>	2,232,909	52,133	589,996			(195,551)		148,688	1,465,635	4,293,810	29,770	4,323,580

**SIGAL UNIQA Group AUSTRIA Sh.a.**  
**Pasqyra e konsoliduar e flukseve monetare**  
*(Të gjitha shumat janë shprehur në mijë Lek)*

	Shënie	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2019	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2018
<b>Flukset monetare nga aktivitetet operative</b>			
<b>Fitimi para tatimit</b>		<b>157,163</b>	<b>364,774</b>
<i>Rregullime për:</i>			
Zhvlerësimin	15	242,610	88,798
Shpenzimi për zhvlerësimin	12	24,762	4,727
Humbje nga shitja e aktiveve afat-gjata materiale		9,043	2,453
Të ardhura nga interesë		(121,395)	(148,308)
Efekti i konvertimit		(17,405)	(168,709)
<b>Flukset monetare të gjeneruara nga operacionet para ndryshimeve në aktivet dhe detyrimet operative</b>		<b>137,615</b>	<b>(221,039)</b>
<i>Ndryshime në aktive dhe detyrime operative:</i>			
Ndryshimi në llogari të arkëtueshme nga sigurimi		(29,877)	(274,248)
Ndryshimi në kostot e shtyra të marrjes në sigurim		(41,386)	(23,659)
Ndryshime në llogaritë e arkëtueshme nga risigurimi		(1,347,479)	31,886
Ndryshimi në aktivet e tjera		(62,562)	23,385
Ndryshimi në detyrime nga aktiviteti risigurues		107,303	(72,416)
Ndryshimi në rezervat për kontratat e sigurimit		2,168,740	150,660
Ndryshimi në detyrimet e tjera		85,828	41,169
Rënje në detyrimin e qirasë		(140,503)	-
Interesa të marra		121,395	95,566
Tatim fitimi i paguar		(92,572)	(186,935)
<b>Flukset monetare të gjeneruara nga aktivitetet operative</b>		<b>1,063,665</b>	<b>(70,857)</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitet investuese.</b>			
Blerje e aktiveve afat-gjata materiale	15	(280,604)	(63,872)
Shuma të marra/vendosje në depozitat me afat		(691,717)	25,423
Rënje/(Rritje) e investimeve në letrave me vlerë		(467)	180,699
<b>Flukset neto monetare të përdorura në aktivitetin investues</b>		<b>(972,788)</b>	<b>142,250</b>
<b>Flukset monetare nga aktivitetet financuese</b>			
Dividendët e paguar	20	(140,000)	(161,000)
<b>Flukset neto monetare të përdorura në aktivitetet financuese</b>		<b>(140,000)</b>	<b>(161,000)</b>
<i>(Rënje)/Rritje neto në mjetet monetare dhe ekuivalentë të tyre</i>		<i>(49,123)</i>	<i>(89,607)</i>
<i>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fillim të vitit</i>		<i>375,496</i>	<i>465,103</i>
<i>Mjete monetare dhe ekuivalentë të tyre në fund të vitit</i>	<i>9</i>	<i>326,373</i>	<i>375,496</i>

## **PËRMBLEDHJE E KONTROLLIT TË BRENDSHËM SIGAL UNIQA GROUP AUSTRIA 2019**

Në përbledhje të punës së bërë nga Departamenti i Kontrollit për vitin 2019 në Shoqërinë Sigal Uniqa Group Austria, po paraqesim veprimtarinë dhe rezultatet ekonomiko-financiare te saj. Nga ana jone, gjate vitit janë pare e kontrolluar te gjithe departamentet në Kompani. Në vijim të raportit, do të paraqesim punën e bërë, rezultatet për departamentin dhe orientimet, si dhe syqerimet tona përvijueshmerine në të ardhmen.

Veprimitaria e Departamentit të Pasurisë. Realizimi i të adhurave në departamentin e pasurise per vitin 2019, ka qene ne nivele te kenaqshme, pare kjo ne kendveshtrimin e konkurencës me Kompanitë e tjera ne tregun e sigurimeve. Jane realizuar 1,069,281,908 leke ose 38,146,448 leke me pak se viti 2018. Por verehet se ne perkeqesimin e sitates ekonomiko financiare ne departamentin e pasurise kane ndikim shpenzimet per vitin 2019 dhe kryesisht shpenzimet per demet e paguara. Ne vitin 2018 janë paguar 57,547,141 leke deme, kundrejt shumes 830,963,083 leke ne vitin 2019 ose 773,415,942 leke deme te paguara me shume. Kjo rritje ne demet e paguara vjen ne zelin “sigurime pasurie” per 180,822,660 leke me shume dhe ne zelin “sigurime banka-para” per 587,930,427 leke paguar me shume se viti 2018. Arsyet janë per zelin e pare demet e ndodhura e paguara per pasojet e termetit ne shtator 2019, dhe per zelin e dyte te permendur ngjarjet e ndodhura ne transportin e parave cash nga bankat (vjetdhja e vlerave monetare te tyre). Ne analizen e bere nga ana jone ne total rezultati negativ per departamentin e pasurise eshte ne shumen 430,911,990 leke dhe po te shtojme edhe perqindjen qe zene shpenzimet administrative ne departament shuma shkon ne 694,846,970 leke. Ne veprimitarne e saj Kompania Sigal Uniqa Group Austria gjithnjë ka bere risigurimet e duhura per te gjitha objektet e marra ne sigurim, te cilat janë me rrisk te larte sigurimi. Per pasoje demet e shkaktuara e paguara qe permendem me siper janë rimbursuar nga shoqerite e risigurimit ne shumen 628,482,292 leke. Dhe ne perfundim rezultati i kompanise eshte renduar per 66,364,678 leke.

Mendojme qe megjithese departamenti ka rezultat jo pozitiv ne treguesit e tij, ka punuar mire duke u pergiqjur ne kohe volumit te madh te punes ne detyrim te kerkesave te klienteve per fatkeqesite e ndodhura. Rezultati negativ nuk eshte pasoje e mosfunkcionimit te punes ne departament por nga shkaqe te cilat nuk varen nga puna e bere. Te gjitha kerkesat e udhezimeve te derguara nga Autoriteti Mbikqyres Financiar janë zbatuar ne kohe dhe sipas formulareve te derguar. Po keshtu kane gjetur zbatim urdherat e udhezimet e Drejtorit te Pergjithshem te Kompanise.

Veprimitaria e Departamentit Motorrik. Krahasuar me vitin 2018, ne departamentin motorrik eshte punuar mire lidhur me realizimin e te ardhurave. Ato per vitin 2019 janë rritur ne masen 3,7 % ose 91,952,000 leke me shume. Por nje pune me e kujdeseshme duhet bere ne shpenzimet e bera ne zerat e sigurimit te departamentit, si komisione agjentesh etj. Ne total zerat e shpenzimeve qe i perkasin departamentit motorrik janë rritur 79,375,691 leke dhe i perkasin kryesisht shpenzimeve per komisione agjentesh. Efektiviteti ne departamentin motorrik ne total duke marre per baze shpenzimet e bera per; komisione agjentesh, risigurime, pagesa demesh, eshte i mire, me diferenca positive krahasuar me te ardhurat e realizuara ne shumen 1,018,953,645 leke. Por me tej nese do te marrim per baze pjesen e shpenzimeve administrative ne baze te perqindjes te totalit te te ardhurave prej 638,451,415 leke, atehere rezultati i departamentit zbret ne 380,502,230 leke. Theksojme se ne trajtimin e bere nga ana jone mbi efektivitetin ne departamentin motorrik kemi marre per baze edhe demet e ndodhura e paguara per llogari te Byrose Shqiptare te Sigurimit, shume e cila eshte 201,050,388 leke.

Puna ne departament vleresuar nga ana jone per gjithe vitit 2019, eshte e mire. Policat shiten te gjitha ne sistemin on-line, per klientet eshte krijuar mundesia e blerjes se tyre direkt nga aparatet

elektronike personale. Zbatohen ne departament te gjitha udhezimet e dhena nga Autoriteti Mbikqyres Financiar dhe dergohen ne afatet e caktuara te dhenat e kerkuara. E njejtë gje edhe per realizimin e nderheresave te Uniqa Group Austria dhe Drejtorit te Pergjithshem. Duhet punuar me shume nga departamenti per uljen ne maksimum te debitoreve nga policmbajtesit, qe jane ne shifra te larta dhe te cilën do ta trajtojme te departamenti i finances.

Veprimtaria e Departamentit Shendetit. Edhe ne departamentin e shendetit eshte punuar mire gjate viti 2019 per nje realizim te ardhurave nga sigurimi. Si pasoje te ardhurat krasuar me vitin 2018 jane rritur ne masen rreth 23 perqind ose ne shume absolute me 81,521,379 leke me shume. Por nuk eshte e njejtë ecuria ne shpenzimet e bera qe ne vitin 2019 krasuar me vitin 2018 jane 35,951,265 leke me shume. Ka rritje ne zerat e shpenzimeve qe ne kemi nxjerre kryesisht per komisione agjenti, dhe deme te paguara. Megjithese duke marre per baze te ardhurat e realizuara, dhe zerat kryesore te shpenzimeve per komisione agjentesh, risigurime dhe deme, ka nje efektivitet ekonomik ne shumen 106,233,506 leke, nese marrim per baze edhe perqindjen e shpenzimeve administrative qe i perket departamentit te shendetit per 107,451,790 leke, atehere verehet se ne total departamenti del me efektivitet ekonomik te ulet.

Per te patur nje permiresim ne te ardhmen te ecurise se efektivitetit te departamentit, nga ana jone rekomandimi do te ishte ne radhe te pare ulja e shpenzimeve per komisione agjentesh, pothuaj ne te gjithe produktet e sigurimit dhe ne produktin shendet privat vec uljes se shpenzimeve per komisione agjentesh te shihet rritja e te ardhurave nepermjet primit te sigurimit, pasi demet e paguara ne kete produkt zene 75 perqind te primit te sigurimit. Departamenti pare ne kontrollin tone gjate viti punon mire, shitjet e produkteve behen on-line, rakordojne dhe te dhenat mbahen dhe dergohen konforme udhezimeve te derguara nga Autoriteti Mbikqyres Financiar, dhe rregullat e vendosura nga Drejtori i Pergjithshem.

Veprimtaria e Departamentit te Marines. Ne departamentin e Marines jane realizuar me shume te ardhura se viti 2018 ne Shumen 34,245,755 leke. Por edhe shpenzimet qe ne grupuan si per departamentet me siper Jane rritur per 12,913,212 leke. Ne departamentin e marines dominojne kryesisht shpenzimet e risigurimit dhe shpenzimet per komisone agjentesh. Shpenzimet per deme te paguara Jane ne shifra te vogla dhe per vitin 2019 Jane 2,787,921 leke. Efekti pozitiv qe rezulton mes te ardhurave e shpenzimeve baze te grupuara nga ana jone, permbyset po te marrim ne konsiderate perqindjen e shpenzimeve administrative.

Nga te dhenat me siper, permiresim te efektivitetit ne departamentin e marines do te jepte zeri "sigurim avione" ne se nuk do te lishte pagesa komisione agjenti. Pasi te ardhurat nga primet ne kete ze sigurimi ne masen 77 perqind e ze risigurimi i bere dhe po te shtojme komisione, ky produkt del pa efektivitet. Produktet e tjera te sigurimit kane qendrueshmeri. Edhe departamenti i marines ka punuar relativisht mire, megjithë perpjekjet qe duhen bere per rritjen e volumit te primeve te sigurimit. Jane zbatuar urdherat e urdheresat e leshuara duke u pergjigjur sakte mbajtjes e raportimit te te dhenave.

Ne total Kompania Sigal Unica Group Austria ka realizuar prime sigurimi nga departamentet e marrjes ne sigurim 4,230,044,277 leke ose 169,572,687 leke me shume se viti 2018, nje pune e mire kjo realizuar nga Kompania. Zerat e grupuar nga ana e jone per shpenzime komisione agjentesh, risigurime, deme te paguara Jane ne Shumen 3,522,704,429 leke ose me shume krasuar me vitin 2018 per 812,027,686 leke. Kjo rritje krasuar me vitin 2018 ka ardhur kryesisht sic edhe kemi paraqitur me siper nga rritja e shpenzimeve per deme te paguara si pasoje e demeve nga termeti dhe atyre te ndodhura ne sigurimin e bankave por edhe te komisioneve te agjenteve. Ne total rezultati i efektit ekonomik eshte pozitiv ne Shumen 707,339,848 leke. Duke pare shpenzimet te tjera administrative bere nga Kompania per 1,043,221,266 leke, atehere verehet lehtesish qe rezultati negativ eshte per 335,881,418 leke dhe duke marre parasysh pagesen e risiguruesve bere per demet te cilat kane qene ne risigurim, per pjesen e

departamenteve Sigal Unica Group Austria ka nje efektivitet ekonomik ne Shumen 292,600,874 leke. Ne kete pasqyrim qe ne kemi bere nuk jane te perfshira rezervat e llogaritura dhe elemente te tjere sic jane te ardhurat dyesore te realizuara. Keto do ti pasqyrojme ne pjesen qe ne do te trajtojme tek pjesa e departamentit te finances.

Veprimtaria e Departamentit te Demeve. Per tu pershtatur dhe per te bere nje pune sa me efektive dhe ne sherbin sa me te mire ndaj klienteve, departamenti i demeve ne Kompanine Sigal Unica Group Austria eshte organizuar ne disa sektore te trajtimit te demeve:

